



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 137 Prot.

Tiranë, më 07 / 06 / 2019

VENDIM

Nr. 9 Datë 07 / 06 / 2019

PËR

**SHPLLJEN E THIRRJES PËR APLIKIM ME PROJEKTE TË KËRKIMIT SHKENCORË
NË KUADËR TË PAKTIT PËR UNIVERSITETIN**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë”; të Ligjit Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të VKM Nr.607 datë 31.08.2016 “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, si dhe të VKM Nr. 75 datë 12.08.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencorë”, Bordi i Administrimit të Agjencisë Kombëtare të kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, i mbledhur më datë _____,

VENDOSI

1. Shpalljen e thirrjes për aplikim me projekte infrastrukturore të kërkimit shkencorë në kuadër të “Paktit për Universitetin”.
2. Në projekte infrastrukturore të kërkimit shkencorë përfshihen paisje apo investime laboratorike, sisteme kompjuterike, informatike etj.
3. Përmes kësaj thirrje do të mbështeten financiarisht projekt-propozime nga institucionet e arsimit të lartë, të cilat plotësojnë komponentët e kërkimit shkencor dhe zhvillimit të infrastrukturës kërkimore akademike (laboratorike). **Fondi i vendosur në dispozicion të kësaj thirrjeje është 170.000.000. ALL.**

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Redi SHTINO

ANËTARËT E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

1. Vasil TOLE

3. Ines MUÇOSTEPA

5. Bisej KAPO

2. Mynyr KONI

4. Elvin GJEVORI

6. Ejona ISUFAJ



4. Projekt propozimet inovative në fushat e teknologjisë së informacionit, inxhinierike, mjekësore, bujqësore dhe ato të shkencave të natyrës si dhe ato projekt propozime të cilat plotësojnë kushtet e VKM nr.188, datë 13.03.2019, *“Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes vendore dhe institucionet në varësi të tyre”*, janë prioritare.

5. Projektet e propozuara duhet të mbështesin dhe të synojnë arritjen e objektivave të kërkimeve shkencore, dhe angazhimet e Paktit për Universitetin. Gjithashtu do të vlerësohet edhe kontributi i këtyre projekteve në përputhje me politikat, strategjitë, misionet dhe vizionet e institucione të arsimit të lartë.

6. Procedura e paraqitjes dhe pranimit të projekt-propozimeve kalon përmes këtyre hapave:

- Paraqitja e kërkesës;
- Metodologjia e vlerësimit;
- Vendimmarrja;
- Lidhja e kontratës.

Paraqitja e Kërkesës

Kërkesa e institucionit të arsimit të lartë për financim në kuadrin e kësaj thirrjeje paraqitet pranë AKKSHI, sipas përcaktimeve të shtojcës 1 (bashkëlidhur), dhe paraqitet në tre kopje.

Projekt-propozimi duhet të shpreh qartë nevojën për ndërhyrje në infrastrukturën akademike të IAL që e propozon. Projekt propozimi duhet të përmbajë dy komponent bazë: atë të kërkimit shkencorë dhe infrastrukturën akademike për realizimin e tij. Projekt propozimi duhet të përshkruaj në mënyrë të detajuar qëndrueshmërinë financiare që ky projekt sjell për institucionin e arsimit të lartë aplikues. Projekt propozimi duhet të përshkruaj në mënyrë të detajuar formën e realizimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës akademike. Institucioni i arsimit të lartë duhet të vërtetojë që do të mirëmbajë infrastrukturën akademike me fondet e tij financiare dhe burimet e tij njerëzore.

Projekt propozimi duhet të përshkruaj se si realizon komponentin e barazisë gjinore për përfituesit.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Redi SHTINO

ANËTARËT E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

1. Vasil TOLE

3. Ines MUÇOSTEPA

5. Bisej KAPO

2. Mynyr KONI

4. Elvin GJEVORI

6. Ejona ISUFAJ



Afati i dorëzimit të projekt propozimit pranë zyrave të AKKSHI, adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri, është data 24 qershor 2019, ora 16:30.

Metodologjia e vlerësimit

Projekt-propozimet vlerësohen nga Komisioni i ekspertëve të vlerësimit, miratohet me vendim të bordit të administrimit të AKKSHI. Ky komision shprehet për cilësinë përmbajtjesore të çdo projekti.

Kriteret specifike të vlerësimit janë si më poshtë:

- Shkalla e ndikimit të projektit në arritjen e objektivave të politikës/strategjisë/misionit të IAL-së dhe impakti në realizimin e masave, sipas drejtimit të thirrjes;
- Kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga IAL-të;
- Niveli i ndikimit të projektit dhe avantazhet në zhvillimin e procesit kërkimor-shkencor dhe atij mësimor-didaktik të IAL-së;
- Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike);
- Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. (studentë/pedagogë, apo komunitet);
- Niveli i bashkëfinancimit suplementarisht/mbi vlerën dysHEME të bashkëfinancimit të projektit.

Projekt-Propozimet që vlerësohen pozitivisht nga Komisioni i ekspertëve të vlerësimit, duhet të kenë të shprehur nga ky komision edhe mendimin e këtij të fundit, për prioritetet që duhen zbatuar në financimin e projekteve dhe vlerën e financimit të secilit prej tyre, nisur nga rëndësia shkencore, pesha që ky projekt ka në arritjen e objektivave dhe fondet e vëna në dispozicion të programit përkatës.

Vendimmarrja

Vlerësimet e Komisionit të ekspertëve të vlerësimit i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI-t, i cili e përcjell listën e programeve që marrin vlerësim pozitiv në Bordin e

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Redi SHTINO

ANËTARËT E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

1. Vasil TOLE

3. Ines MUÇOSTEPA

5. Bisej KAPO

2. Mynyr KONI

4. Elvin GJEVORI

6. Ejona ISUFAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Administrimit. Bordi i Administrimit merr vendimin përfundimtar për listën fituese të projekteve të propozuara.

Lidhja e Kontratës

Nëse projekt-propozimi miratohet për financim, lidhet kontrata ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI-t dhe institucionit të arsimit të lartë që ka paraqitur kërkesën, të përfaqësuar nga drejtuesi i tij dhe drejtuesi i projektit. Në kontratë përcaktohet mënyra e monitorimit periodik për zbatimin e projektit.

7. Ky vendim hartohet në 2 (dy) kopje.

8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Redi SHTINO

ANËTARËT E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

1. Vasil TOLE

3. Ines MUÇOSTEPA

5. Bisej KAPO

2. Mynyr KONI

4. Elvin GJEVORI

6. Ejona ISUFAJ